

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një bravo për Altin Dumanin dhe Bledar Maksutin me shokë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/27/nje-bravo-per-altin-dumanin-dhe-bledar-maksutin-me-shoke/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 13:55:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	27 shtator 2026, 13:49:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 27 shtator 2026, 13:48:00 UTC → 27 shtator 2026, 13:50:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2ca2f7c485069848deecafe84300b68ce12a41a353516200a225ef065375f709
TEKSTI	b908012309688d2b68db68d7dda8eb47bcfc363ab5d0474fcbd56e1d92b8a5db
PAMJA	e1f6df058f2f851952240e144f93f38cc8a147bb9d60df51bc44f9bb4f7532d0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6f23a7759cbcc189c99027e58623d8acdbcaa0022b8949ee5a3418bbdebb038d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9def72ec67cc19e19d7afdb89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6f23a7759cbcc189c99027e58623d8acdbcaa0022b8949ee5a3418bbdebb038d>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

OPINION | TË FUNDIT

Një bravo për Altin Dumanin dhe Bledar Maksutin me shokë

27/09/2026 15:49



Nga Preç Zogaj

Sot, kur gjithë vëmendjen e publikut e ka marrë superskandali i fshehjes së një të kërkuari në arrati nga vetë kryetarja, tashmë e shkarkuar, e Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni, dhe nga zyrtarë të tjerë me grada dhe poste në Policinë e Shtetit, është rasti të kuptojmë edhe një herë një gjë të thjeshtë: sa të vështirë e kanë rojtaret besnikë të ligjit dhe shtetit, aq sa janë, në një ekosistem politik të degraduar në ekstrem prej vitesh nga simbioza e krimit në pushtet dhe pushtetit në krim në shumë segmente të qeverisjes qendrore dhe vendore.

Është e vërtetë se këta rojtare të ligjit dhe shtetit bëjnë detyrën për të cilën paguhën. Me siguri kështu e mendojnë edhe ata vetë, përndryshe do t'u kishte marrë koka erë me kohë. Por, sado modestë e kokulur të jenë, ata janë heronj. Heronj në kontekstin e tradhtisë që ndeshin në institucione shtetërore që duhet t'i kenë në krah, por që u punojnë prapa krahëve, duke u bërë njësh me krimin dhe kriminelët.

Për një situatë të tmerrshme si kjo, mendjendrituri Monteskie do të thoshte se është helmuar vetë ilaçi – vetë institucioni që ekziston për të luftuar të keqen.

Kush mund ta imagjinonte se i shumëkërkuari E.Agasi fshihej në veturën e shefes së shërbimit sekret të Republikës dhe ishte nën mbrojtjen e saj në çdo hap të ilegalitetit të tij?

Kushdo i merr me mend vështirësitë për t'u rënë në gjurmë një të kërkuari të tillë dhe bashkëpunëtorëve të tij.

Për fat, jo gjithë institucionet shtetërore janë një ilaç i helmuar. SPAK është kryesori ndër ta që po e lufton të keqen kudo ku shfaqet, pa parë as majtas, as djathtas. Sot është rasti t'u themi një bravo të madhe prokurorëve të këtij institucioni, Altin Dumanit e Bledar Maksutit, që kanë udhëhequr hetimin e një afere korruptive komplekse me përfshirje të gjerë politike si ajo e AKSHI-t (Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit).

Kjo agjenci ishte promovuar si një mrekulli e qeverisjes digjitale, sipas narrativës zyrtare, por ka rezultuar të jetë edhe një depozitë e madhe parash për oktapodët e korrupsionit dhe krimit në sistem, sipas hetimeve të deritanishme.

Një bravo të veçantë gjithashtu për zbulimin dhe vënien nën akuzë së fundmi të ish-kryetares së SHISH, duke qenë në detyrë, për dy vepra penale: përkrahje e autorit të krimit dhe nxjerrje e sekreteve shtetërore.

Dumani, që udhëhoqi si drejtues i SPAK për disa vite normalizimin e hetimit në sferat e larta dhe jetësimin e parimit "askush mbi ligjin" – duke zgjidhur nyjen gordiane të krizës endemike të drejtësisë sonë (pa hetim dhe akuzë s'ka as gjykatë) – shfaqet përsëri po ai që njohim.

I Kryesore



E PLOTË/ "Si ka mundësi që nuk e dija?", mesazhi i Ramës pas akuzave të SPAK për zyrtarët pranë tij: Kam fajet e mia, por jam këtu për të bërë histori e jo pasuri

15:36

"Orët më janë dhuruar nga miq të fuqishëm", Rama: I kam regjistruar si prona të shtetit

14:51

Alarm në gjykatë, rriten divorcet në Lushnje, muaji gusht shënoi pikun me 20 raste të reja

12:45

"Fiks Fare" gati për sezonin e ri/ Provat e fundit në studion e re, Olta Gixhari dhe Dorian Ramaliu gati për premierën më 28 shtator

12:53

Pas fitores me Bjellorusinë, kombëtarja përgatitet për San Marinon, historiku i përballjeve mes tyre

11:39

I Më të lexuarat

Thirrja urgjente/ Rama mesazh shqiptareve nga Rinas direkt pas kthimit nga SHBA, zbardhen detajet

VIDEO/ Shqipëria në versionin "turbo", kuqezinjtë dominojnë Bjellorusinë dhe marrin 3 pikë të merituar

Kryeministri Rama mbërrin nga New York në orën 13:00, burime qeveritare tregojnë për Top Channel çfarë pritet të deklarojë nga salla VIP në Rinas

Top Channel publikoi videon e Peter Magyar, ja si reagon kryeministri hungarez (FOTO)

"Jeni rrezik për sigurinë kombëtare"/ Azgan Haklaj dhe Ferdinand Samarxhiu ndalohen në kufi me Maqedoninë e Veriut

"Asisti më i bukur në karrierë"/ Hysaj flet për të ardhmen: I kam kërkuar presidentit Duka kontratën e veçantë

Kryeministri Rama mbërrin në aeroportin e Rinasit, pritet deklarata e paralajmëruar

FOTO/ Nga "Arrestoni Ramën" te mbështetja për liderët e UÇK, pankartat politike marrin vëmendjen në ndeshjen e Kombëtares

Aksident tragjik në Maliq/ Nuk kapi frenat e dorës, makina rrëshqet dhe e zë poshtë, humb jetën 44-vjeçari

Atentati në Athinë, 25 plumba në kafene/ Ja çfarë i tha Denis Luli kamarierit para sulmit

Kësaj radhe si prokuror i thjeshtë, që vazhdon të japë shembullin dhe të jetë me kolegün e tij Maksuti dhe gjithë ekipin e SPAK në misionin historik të vendosjes së sundimit të ligjit në Shqipëri.

Tingëllon si parullë kur e dëgjon, por ka vlerën e një ngjarjeje që ndan historinë tonë: para dhe pas xhunglës; para dhe pas pandëshkueshmërisë në sistem; para dhe pas sundimit të bajraktarëve politikë.

I vënë në jetë, i bërë normë e jetës dhe civilizimit tonë, ky parim ka ndërkaq vlerën e kartës "magjike" për të hapur portën e fundit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Pa të nuk hapet.

Establishmenti politik Rama-Berisha është në kundërshti dhe hipokrizi kur, nga një anë, predikon me fjalë integrimin në BE dhe, nga ana tjetër – duke qenë vetë ose bashkëpunëtorët e tyre subjekte të hetimeve – janë në një betim të shenjtë nga pozicionet respektive kundër SPAK. Veç mos u rëntë në dorë!

Nuk do t'u bjerë në dorë. As ky që është, e as ai që do të vijë pas tij. Me gjithë mangësitë apo gabimet që bën rrugës, është vetë SPAK që po shënon me hetimet e veta pa tabu dhe me përvojën që fiton, stadin e një pavarësie të pacënueshme e të pakthyeshme. Koha dhe ngjarjet punojnë për këtë pavarësi. Pra, mbështetja e tij nga BE-ja mbetet konstante.

Ardhja dhe e ambasadorit të ri të SHBA-së, Eric Wendt, shkon në këtë linjë. Nisur nga prioritetet e tij të shpallura, ku lufta kundër korrupsionit dhe krimin janë në krye të listës, ka arsye të besohet plotësisht se SPAK do të marrë më shumë forcë e frymëzim nga mbështetja e aleatit strategjik.

Në fakt, ende pa mbërritur ai në Tiranë, SPAK e përshëndeti përfaqësuesin më të lartë të SHBA-së me disa akte të rëndësishme, siç është thellimi i hetimeve ndaj aferave të dyshuara të ish-zëvendëskryeministres Belinda Balluku, apo vënia nën akuzë e Vlora Hysenit, që çoi në shkarkimin e saj.

E ardhmja premton ditë të këqija për korrupsionin dhe krimin. Ditë të mira për vendin.

Top Channel

I Opinion »



"Humori, Parlamenti apo qeveria: Kush të bën të qeshësh më shumë?"

26/09 19:07



Satira e Gjekmarkajt për seancën parlamentare: "Babo digjet e Klodi krihet", kush janë "trimat" dhe "tradhtarët"

26/09 19:00



Opinion nga Lorenc Vangjeli: Ish-shefja e SHISH nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqët e saj

25/09 20:50



"Urgjenca e SPAK-ut për ta bërë publik arrestimin fsheh një hall të madh" / Analiza e Filip Çakulit: Vlora Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë

23/09 18:25



Ku janë provat materiale? 96 vrasje – 96 viktima – 96 dosje provash!

23/09 18:20



Shqipja ka nevojë për një rinovim digjital

23/09 13:43

Na ndiqni:


Top Channel

@topchannelalbania

@tchbreakingnews

Top Channel

I Video »



Top Channel / 60 ditë kohë për pronën / Regjistrimet nga kadastra, do të afishohen listat dhe ...



Top Channel/ RMV bllokon Azgan Haklajn/ Maqedonia e Veriut nuk lejon hyrjen e ish-deputetit




Top Channel / Rama mesazh Spak për SHISH / “Vlora Hyseni të përballlet me drejtësinë, por linçimi...”



Top News – Atentati në Athinë, 25 plumba drejt tij, Luli u la një porosi kamarierëve



Top News – Shpërthimi vdekjeprurës në Plaka. Ekspertët nisin hetimet, gjithçka nën ‘mikroskop’



Top Channel/ “Xing” në Rinas/ Rama kthehet nga New York, Berisha ikën në Strasburg

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për’puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.